



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 21 Prill 2021

Nr: 266

**VENDIM**

**PËR**

**MIRATIMIN E PËRKTHYESVE TË ASAMBLESË PARLAMENTARE TË OSBE-SË DHE  
VËZHguesve AFATGJATË TË OSBE PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE PËR  
KUVEND  
TË DATËS 25 PRILL 2021**

Në mbështetje të neneve 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.2, datë 02.02.2021 “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore”, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

**VENDOS:**

1. Të miratojë kërkesën e Asamblesë Parlamentare të OSBE-së për akreditimin e 33 (tridhjetë e tre) përkthyesve për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 Prill 2021 sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë kërkesën e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri për akreditimin e 1 (një) vëzhguesi afatgjatë për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 Prill 2021 sipas lidhjes 2 bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Ilirjan CELIBASHI**

